



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK DHE**  
**BASHKËRENDIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ**  
**DREJTORIA E STRATEGJISË DHE MONITORIMIT TË BORXHIT**  
**Saktori i Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit**



**BULETINI STATISTIKOR I BORXHIT**

Shtator 30, 2020

## PREZANTIMI

Buletini i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Statistikat e Borxhit është një raport statistikor i përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj. Objektivi kryesor i këtij Buletini është të sigurojë për një publik të gjerë informacion mbi borxhin jashtëm dhe të brendshëm të *sektorit buxhetor të qeverisë qendrore, borxhin e garantuar si edhe borxhin e pushtetit lokal*. Ai ka si qëllim të sigurojë informacion të përditësuar dhe të nevojshëm mbi stokun dhe transaksionet e borxhit, për të siguruar transparencën mbi portofolin e borxhit të Qeverisë Qendrore lidhur me:

- Borxhin e brendshëm të sektorit buxhetor të qeverisë qendrore
- Borxhin e jashtëm të sektorit buxhetor të qeverisë qendrore
- Garancitë e huave
- Operacionet e lidhura me borxhin
- Borxhin e pushtetit lokal

Buletini nuk përfshin ndonjë analizë të plotë, duke qënë se qëllimi i tij është t'u japë përdoruesve lirinë për të përdorur të dhënat për të vijuar kërkimet/analizat e tyre.

Buletini është i strukturuar si më poshtë:

### **Parathënie: Aspekte të Përgjithshme dhe Specifike rreth Buletinit**

Parathënia jep një informacion të përgjithshëm mbi Buletinin si mbulimin, metodologjia, shënimet mbi klasifikimin, frekuencën dhe afatet kohore të botimit.

### **Pjesa 1: Borxhi i Brendshëm dhe i Jashtëm**

Ky seksion përmban një numër tabelash që përshkruajnë pozicionin e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm të sektorit buxhetor të qeverisë qendrore duke përfshirë garancitë shtetërore, sipas maturimit, monedhës, interesit si edhe grafikët përkatës ilustrues. Gjithashtu këtu jepen të dhënat e borxhit të qeverisjes vendore në një nivel agregat.

### **Pjesa 2: Borxhi i Brendshëm**

Ky seksion përmban informacion më të detajuar mbi strukturën e borxhit të brendshëm të sektorit buxhetor të qeverisë qendrore, mbajtësit e borxhit të brendshëm, kurbën e Yield-it Mesatar të Ponderuar dhe Ditëve Mesatare në Maturim.

### **Pjesa 3: Borxhi i Jashtëm**

Ky seksion përmban informacion mbi indikatorët e borxhit të jashtëm të sektorit buxhetor të qeverisë qendrore dhe borxhin e garantuar, përfshirë disbursimet dhe shërbimin e borxhit. Tabelat dhe grafikët sigurojnë informacion për strukturën e borxhit sipas maturimit, kreditorëve, sektorëve ekonomikë, monedhës, tipit të interesit dhe sipas koncensionalitetit. Gjithashtu jepen të dhënat mbi vlerën e padisbursuar të kredive.

Buletini përmban edhe anekse në të cilat, me anë të tabelave dhe grafikëve jepen informacione të tjera mbi borxhin.

## PARATHËNIA

### *Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkëndimit të Ndhmës së Huaj*

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkëndimit të Ndhmës së Huaj përgatit Buletinin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Statistikat e Borxhit, mbi baza tremujore duke përdorur bazën e saj të të dhënave<sup>1</sup>. Drejtoria ka disa përgjegjësi, mes tyre edhe regjistrimin e transaksioneve të borxhit të sektorit buxhetor të Qeverisë Qendrore dhe Garancive Shtetërore.

### *Mbulimi dhe metodologjia*

Nëpërmjet këtij buletini publikohen të dhënat e borxhit të sektorit *buxhetor të qeverisë qendrore, qeverisë lokale dhe borxhit publik të garantuar*.

Vlen të përmendet se, si pjesë e politikës së saj të transparencës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është regjistruar në disa inisiativa ndërkombëtare në fushën e publikimit të të dhënave të borxhit, përfshirë Sistemin e Publikimit të Dhënave të Përgjithshme (GDDS) dhe të Statistikave të Borxhit të Sektorit Publik (PSDS) të cilët menaxhohen nga Banka Botërore. Gjithashtu, në nivel kombëtar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë publikon informacion të rëndësishëm mbi emetimet e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar në linkun: <http://www.financa.gov.al/al/raportime/borxhi/ankandet-e-emetimit-te-letrave-me-vlere-te-qeverise> dhe i paraqet një raport vjetor të specializuar Kuvendit.

### *Mbulimi i këtij buletini*

Ky buletin siguron informacione që mbulojnë:

- ✓ Borxhin e jashtëm të qeverisë qendrore buxhetore
- ✓ Borxhin e brendshëm të qeverisë qendrore buxhetore
- ✓ Borxhin shtetëror të garantuar të jashtëm dhe të brendshëm
- ✓ Borxhin e qeverisë vendore.

### *Klasifikimi*

Klasifikimi i të dhënave të borxhit të përdorur në këtë buletin synon të përputhet me standartet e vendosura në “Statistikat e Borxhit në Sektorin Publik – Guidë për Hartuesit dhe Përdoruesit” (2013) përveçse kur specifikohet ndryshe në shënimet e poshtme dhe të dhënat e veçanta përkatëse.

-Borxhi i Brendshëm përfshin letrat me vlerë të qeverisë (bono thesari dhe obligacione) të emetuara në tregun e brendshëm nga Qeveria Qendrore dhe borxhin e garantuar të mbajtur nga subjektet që operojnë në tregun e brendshëm.

-Borxhi i Jashtëm përfshin huatë e huaja të kontraktuara mes kreditorëve të huaj dhe Qeverisë Qendrore si edhe instrumentat e emetuara në tregun financiar ndërkombëtar nga Qeveria Qendrore.

-Borxhi i Jashtëm i Garantuar i referohet huave të nënshkruara mes kreditorëve të huaj dhe ndërmarrjeve publike apo private, për të cilat Qeveria Qendrore ka dhënë garanci.

---

<sup>1</sup> Ministria e Financave kryesisht përdor sistemin DMFAS 6 të siguruar nga UNCTAD për regjistrimin, monitorimin dhe raportimin e të dhënave të borxhit.

### ***Frekuenca***

Ky Buletin i statistikor përgatitet çdo tre muaj dhe publikohet brenda muajit pasardhës të çdo tremujori. Buletini i treguesve të fundit të vitit publikohet jo më vonë se tre muaj pas mbylljes së vitit.

### ***Vlerësimi***

Bonot e thesarit raportohen në çmim blerje, ndërkohë që obligacionet afatgjata raportohen në face value. Interesat e akumuluar nuk përfshihen.

### ***Kursi i këmbimit***

Për vlerësimin e stokut, përdoren kurset e këmbimit në fund të periudhës.

### ***Komisionet***

Të gjithë komisionet përfshihen në interesat e borxhit.

### ***Pagesat e prapambetura***

Gjithë pagesat e prapambetura për kreditë apo letrat me vlerë të qeverisë (nëse ka) përfshihen në borxhin total. Në këtë rast, tabela shoqërohet me shënimin përkatës.

### ***Disa konsiderata në veçanti për buletin shqiptar***

#### ***Borxhi i garantuar i prezantuar në këtë publikim ka këto karakteristika:***

Borxhi i Garantuar përkufizohet ndryshe nga Guida dhe konsiderohet nga legjislacioni shqiptar<sup>2</sup> si pjesë integrale ekzistuese e borxhit të Qeverisë Qendrore, rrjedhimisht nuk është një detyrim plotësisht i ndarë, i shkaktuar nga një ngjarje e veçantë dhe që do të riklasifikohet dhe të supozohet nën Borxhin Qendror të Qeverisë.

#### ***Pagesat e prapambetura për kreditë apo për letrat me vlerë të qeverisë***

Në periudhën aktuale nuk ka pagesa të prapambetura të huave apo të letrave me vlerë.

#### ***Mbi borxhin e qeverisë vendore***

Buletini përmban vlerat për borxhin e qeverisë vendore, ndaj bankave të nivelit të dytë në nivel agregat, të cilat Drejtoria e Borxhit i llogarit duke përdorur të dhëna të marra nga burime të tjera brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (sistemi AGFIS), nga raportimet e bashkive dhe bankat huadhënëse.

Qeveritë Vendore lejohet të marrin hua bazuar në ligjin Nr.9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisë Vendore”.

---

<sup>2</sup> Ligji No. 57, datë 02.06.2016 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin no.9936 datë 26.06.2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

## AKRONIME

### KREDITORËT

|           |                                                |
|-----------|------------------------------------------------|
| CEB       | Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës      |
| EBRD      | Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim     |
| EC        | Komisioni European                             |
| EIB       | Banka Europiane e Investimeve                  |
| IBRD      | Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim |
| IDA       | Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim             |
| IDB       | Banka Islamike për Zhvillim                    |
| IFAD      | Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë  |
| IMF       | Fondi Monetar Ndërkombëtar                     |
| OPEC/OFID | Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar         |

### MONEDHAT

|     |                                        |
|-----|----------------------------------------|
| ACU | ACU=ID (Dinari Islamik)                |
| AED | Dihrami i Emirateve të Bashkuara Arabe |
| ALL | Lekë Shqiptare                         |
| EUR | Euro                                   |
| JPY | Jen Japonez                            |
| KRW | Won i Koresë së Jugut                  |
| KWD | Dinari Kuvajtjan                       |
| SAR | Rial i Arabisë Saudite                 |
| SDR | Të drejtat speciale të tërheqjes       |
| USD | Dollari i Shteteve të Bashkuara        |

### TË TJERA

|     |                                               |
|-----|-----------------------------------------------|
| BOA | Banka e Shqipërisë                            |
| CUB | Balanca e Vlerës së Angazhuar të Padisbursuar |
| GDP | Prodhim i Brendshëm Bruto                     |
| WAM | Ditë Mesatare Maturimi.                       |
| WAY | Yield-i Mesatar i Ponderuar                   |

## FJALORI

|                         |                                                                                                                                                                            |
|-------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Balanca e padisbursuar: | Fonde të angazhuara nga kreditori por ende të papërdorura nga huamarrësi.                                                                                                  |
| Bono thesari:           | Bonot e thesarit janë letra me vlerë të tregtueshme të emetuara nga qeveria. Në përgjithësi, këto janë me detyrime afatshkurtra të emetuara me maturim një vit apo më pak. |
| Borxhi afatgjatë:       | Borxhi që ka një maturim më të gjatë se një vit.                                                                                                                           |

|                                         |                                                                                                                                                                                                     |
|-----------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Borxhi afatshkurtër:                    | Borxhi me maturim një vit ose më të ulët.                                                                                                                                                           |
| Borxhi Bruto:                           | Shpesh i quajtur “borxhi total” ose “detyrimet e përgjithshme të borxhit” – konsiston në gjithë detyrimet që janë instrumenta të borxhit.                                                           |
| Borxhi i Brendshëm:                     | Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një ekonomie ndaj rezidentëve të së njëjtës ekonomie.                                                                                                         |
| Borxhi i garantuar:                     | Përkufizohet si detyrimet e borxhit të njësive të sektorit publik dhe privat, shërbimi i të cilit është i garantuar, në bazë të marrëveshjeve, nga Qeveria Qendrore.                                |
| Borxhi i Jashtëm:                       | Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një ekonomie ndaj jorezidentëve.                                                                                                                              |
| Borxhi publik i garantuar:              | Borxhi publik i garantuar është i përkufizuar si detyrimet e borxhit të njësive të sektorit publik dhe privat, shërbimi i të cilit është i garantuar kontraktualisht nga njësitë e sektorit publik. |
| Çmim blerje:                            | Gjithashtu njihet si vlera e emetimit për bonot e thesarit.                                                                                                                                         |
| Disbursim:                              | Transaksioni që siguron burimet financiare.                                                                                                                                                         |
| Hua Koncesionale:                       | Kredi që përfshijnë terma më të favorshme sesa kreditë e tregut.                                                                                                                                    |
| Hua/Kredi:                              | Kredia është një instrument financiar që krijohet kur kreditori jep hua fonde direkt një debitori dhe merr një dokument të panegociueshëm (marrëveshje) si provë e aseteve.                         |
| Huadhënës:                              | Shiko kreditorin.                                                                                                                                                                                   |
| Instrumentat e Borxhit:                 | Një instrument i borxhit është i përkufizuar si një pretendim financiar që kërkon pagesa interesi dhe/ose principali nga huamarrësi për kreditorin në datën, ose datat, në të ardhmen.              |
| Instrumentat të tregtueshëm të Borxhit: | Përfshihen bonot e thesarit, obligacionet etj, të emetuara në tregun e brendshëm apo të huaj, të cilat tregtohen në tregjet financiare.                                                             |

|                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|-----------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Interesi:                   | Interesi është një formë të ardhurash nga investimet, që merret nga zotërues të disa lloj asetesh financiare (instrumentet e borxhit dhe kreditë), të cilët i kanë vënë këto burime financiare apo burime të tjera në dispozicion të një njësie tjetër institucionale. Norma e interesit është shuma e kontraktuar për tu paguar në një njësi kohe për secilën njësi të kapitalit të investuar.                                                                                                                   |
| Klubi i Parisit:            | Është një grup informal i ekonomive më të mëdha botërore, i cili jep shërbime financiare si ristrukturimi i borxhit, lehtësimi i borxhit dhe anulimi i borxhit ndaj vendeve që janë në borxh.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Koha mesatare e maturimit:  | Koha mesatare e maturimit mat ditët mesatare të maturimit për gjitha pagesat e principalit në portofol. Ajo tregon se sa kohë duhet mesatarisht për të rinovuar portofolin e borxhit. Ulja e këtij indikator sugjeron se portofoli po rinovohet më shpesh prandaj është më i ekspozuar ndaj goditjeve të rifinacimit.                                                                                                                                                                                             |
| Koha mesatare për rifiksim: | Koha mesatare për rifiksim është një masë e kohës mesatare të ponderuar derisa gjithë pagesat e principalit në portofolin e borxhit bëhen subjekt i një norme të re interesi. Për obligacionet me kupon zero dhe obligacionet me kupon fiks, ajo korrespondon me pjesën e mbetur të kohëzgjatjes së obligacionit. Një ulje e këtij indikator, tregon që portofoli, mesatarisht, po përballlet me një normë interesi të re më shpesh dhe rrjedhimisht është më i ekspozuar ndaj goditjeve të normave të interesit. |
| Kreditor:                   | Organizata apo entiteti që siguron para apo burime dhe ndaj të cilit bëhen pagesat në përputhje me termat e marrëveshjes së kredisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Kreditorë Bilateralë:       | Kreditorët zyrtarë bilateralë përfshijnë qeveritë dhe agjensitë e tyre, ente publike autonome dhe agjensitë zyrtare të kreditimit të eksportiteve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |

|                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kreditorë privatë:            | Kreditorë të cilët nuk janë as qeveri dhe as agjensi të sektorit publik.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Kreditorë shumëpalësh:        | Këto kreditorë janë institucione shumëpalëshe si FMN dhe Banka Botërore, si dhe banka të tjera shumëpalëshe për zhvillim.                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Letra me vlerë:               | Një dokument që i jep të drejta mbajtësit të tij mbi para, të mira apo prona. Gjithashtu i referohet edhe instrumentave që sigurojnë të ardhura si stoqet, obligacionet etj që tregtohen në tregun primar (ose sekondar). Shpesh ky term përdoret për letrat me vlerë të borxhit të cilat janë të tregtueshme në tregun financiar - si bono, obligacione, çertifikatat e depozitave, etj |
| Maturimi i mbetur:            | Periudha e kohës deri sa pagesat e borxhit të përfundojnë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Maturimi mesatar i ponderuar: | Maturimi mesatar i ponderuar (WAM) është koha mesatare e ponderuar deri në maturimin e instrumentave të përfshira në portofolin e borxhit.                                                                                                                                                                                                                                               |
| Maturimi origjinal:           | Maturimi origjinal është periudha nga dita e emetimit deri në përfundimin sipas kontratës. (Shiko gjithashtu maturimin e mbetur).                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Maturimi:                     | Maturimi për një instrumet borxhi i referohet kohës deri në të cilën borxhi do të shuhet sipas marrëveshjes mes debitorit dhe kreditorit. Në guidat statistikore kjo periudhë llogaritet ose nga dita e lindjes ose nga data e references (respektivisht maturimi origjinal/maturimi i mbetur) e detyrimit të borxhit, deri në datën kur ky detyrim do të shuhet.                        |
| Obligacionet:                 | Obligacionet janë letra me vlerë të tregtueshme të emetuara nga qeveria. Ato janë detyrime afatgjata, të emetuara me maturim mbi një vit.                                                                                                                                                                                                                                                |
| Principal:                    | Kapital i investuar ose paratë e dhëna hua apo të marra hua, për të cilat mund të paguhet ose jo interes.                                                                                                                                                                                                                                                                                |

|                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Qeveri vendore:                           | Njësi të qeverisjes vendore janë njësitë e niveleve të ndryshme vendore, të krijuara me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes vendore, brenda një territori të caktuar.                                                                                                                                                                  |
| Qeveria Qendrore Buxhetore <sup>3</sup> : | Është një njësi e vetme e qeverisë qendrore e cila përfshin aktivitetet themelore të pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor kombëtar. Ky komponent i qeverisë së përgjithshme zakonisht mbulohet nga buxheti kryesor (i përgjithshëm). Të ardhurat buxhetore të qeverisë qendrore si dhe shpenzimet, janë normalisht të rregulluara dhe kontrolluara nga Ministria e Financave.  |
| Qeveria Qendrore: <sup>4</sup>            | Nënspektori i qeverisë qendrore përbëhet nga njësitë institucionale të qeverisë qendrore. Autoriteti politik i qeverisë qendrore shtrihet në të gjithë territorin e vendit. Zakonisht ajo përbëhet nga qeveria qendrore buxhetore, njësitë ekstrabuxhetore dhe fondet e sigurimeve shoqërore (përveç rasteve kur fondet e sigurimeve shoqërore trajtohen si një nënspektori i veçantë). |
| Riskedulimi i Borxhit:                    | Riskedulimi i borxhit është një marrëveshje dypalëshe mes kreditorit dhe huamarrësit, që konsiston në shtyrjen e pagesave të borxhit dhe aplikimin e një maturimi të ri dhe zakonisht më të zgjatur.                                                                                                                                                                                    |
| Spektori Publik:                          | Sipas Guidës së FMN-së për statistikat e borxhit të jashtëm, sektori publik përfshin qeverinë e përgjithshme, autoritetin monetar dhe korporatat publike (financiare dhe jo financiare).                                                                                                                                                                                                |
| Shërbimi i Borxhit:                       | I referohet pagesave si të principalit edhe të interesit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Stoku i Borxhit të Disbursuar (DOD):      | Shuma që është disbursuar por që nuk është paguar ose falur, ose thënë ndryshe, totali i disbursimeve duke zbritur ripagesat e kryera.                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Stoku i borxhit:                          | Shiko DOD                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |

<sup>3</sup> Sipas Guidës së PSDS neni 2.26

<sup>4</sup> Sipas përkufizimit në Guidën e PSDS

|                                         |                                                                                                                                                                                                                                        |
|-----------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Të drejtat speciale të tërheqjes (SDR): | SDR-të janë asete rezerve ndërkombëtare të krijuara nga FMN dhe i alokohen anëtarëve të saj për të plotësuar rezervat e tyre.                                                                                                          |
| Tërheqje:                               | Shiko disbursimin.                                                                                                                                                                                                                     |
| Vlera e Angazhuar e Padisbursuar:       | Shiko balancën e padisbursuar.                                                                                                                                                                                                         |
| Yieldi mesatar i ponderuar:             | Llogaritet duke shumëzuar yieldin e çdo instrumenti me vlerën nominale të instrumentit. Këto rezultate mbledhen dhe pjestohen me vlerën nominale të instrumentave të portofolit.                                                       |
| Yield-i Mesatar:                        | Yieldi mesatar në një investim ose në një portofol që llogaritet duke mbledhur gjithë interesat, dividendët apo të ardhura të tjera të gjeneruara nga investimet gjatë një periudhe, të pjestuara me investimet mesatare të periudhës. |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kontakti:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj<br>Drejtoria e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit<br>Ministria e Financave dhe Ekonomisë                                                                                                                                                                                    |
| Adresa : Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 3, Tiranë                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Personat përgjegjës:<br>Irena Gjika, Koordinator, e-mail: <a href="mailto:Irena.Gjika@financa.gov.al">Irena.Gjika@financa.gov.al</a><br>Eriola Allmetaj; e-mail: <a href="mailto:Eriola.Allmetaj@financa.gov.al">Eriola.Allmetaj@financa.gov.al</a><br>Sonila Shamata; e-mail: <a href="mailto:Sonila.Shamata@financa.gov.al">Sonila.Shamata@financa.gov.al</a> |

***Të dhënat e referencave të përzgjedhura nga buletini i statistikave të borxhit***

|                                                                    | 2015     | 2016     | 2017    | 2018    | 2019    | Q3 2020  |
|--------------------------------------------------------------------|----------|----------|---------|---------|---------|----------|
| Prodhimi i Brendshëm Bruto <sup>5</sup><br>(në miliard lekë)       | 1.434,31 | 1,472.48 | 1550,64 | 1635,72 | 1678,43 | 1,580.96 |
| Norma e Këmbimit<br>(në fund të periudhës)<br>ALL:EUR <sup>6</sup> | 137.28   | 135.23   | 132.95  | 123.42  | 121.77  | 124.05   |

<sup>5</sup> Burimi: Departamenti Makroekonomik , Ministria e Financave dhe Ekonomisë

<sup>6</sup> Burimi: Banka e Shqipërisë

Pjesa 1: Borxhi i Brendshëm dhe i Jashtëm  
Part 1: External and Domestic Debt

Borxhi Qeverisë Qendrore Buxhetore, i Pushtetit Lokal dhe Borxhi i Garantuar  
Budgetary Central, Local and Government Guaranteed Debt Stock

in million njësi të monedhës

in millions

|          |                                                                          | 2010           |              | 2011           |              | 2012           |              | 2013           |              | 2014           |              | 2015             |              | 2016             |              | 2017             |              | 2018             |              | 2019             |              | 2020 Q3          |               |                                                                    |
|----------|--------------------------------------------------------------------------|----------------|--------------|----------------|--------------|----------------|--------------|----------------|--------------|----------------|--------------|------------------|--------------|------------------|--------------|------------------|--------------|------------------|--------------|------------------|--------------|------------------|---------------|--------------------------------------------------------------------|
|          |                                                                          | ALL            | EUR          | ALL            | EUR          | ALL            | EUR          | ALL            | EUR          | ALL            | EUR          | ALL              | EUR          | ALL              | EUR          | ALL              | EUR          | ALL              | EUR          | ALL              | EUR          | ALL              | EUR           |                                                                    |
| <b>A</b> | <b>Borxhi i Qeverisë Qendrore, Lokale dhe Borxhi i Garantuar ( B+E )</b> | <b>715.518</b> | <b>5.156</b> | <b>772.732</b> | <b>5.562</b> | <b>828.265</b> | <b>5.934</b> | <b>885.079</b> | <b>6.313</b> | <b>977.965</b> | <b>6.978</b> | <b>1.043.229</b> | <b>7.599</b> | <b>1.066.611</b> | <b>7.887</b> | <b>1.088.169</b> | <b>8.185</b> | <b>1.107.285</b> | <b>8.972</b> | <b>1.112.626</b> | <b>9.137</b> | <b>1.260.782</b> | <b>10.163</b> | <b>Budgetary Central, Local and Government Guaranteed Debt</b>     |
| 1        | I Jashtëm                                                                | 307.999        | 2.219        | 333.935        | 2.404        | 357.622        | 2.562        | 363.906        | 2.596        | 412.429        | 2.943        | 490.898          | 3.576        | 504.589          | 3.731        | 510.286          | 3.838        | 526.259          | 4.264        | 514.754          | 4.227        | 616.529          | 4.970         | External                                                           |
| 2        | I Brendshëm                                                              | 407.519        | 2.937        | 438.797        | 3.158        | 470.643        | 3.372        | 521.173        | 3.717        | 565.536        | 4.036        | 552.331          | 4.023        | 562.021          | 4.156        | 577.883          | 4.347        | 581.026          | 4.708        | 597.872          | 4.910        | 644.252          | 5.193         | Domestic                                                           |
| <b>B</b> | <b>Borxhi Qeverisë Qendrore Buxhetore dhe Borxhi i Garantuar ( C+D )</b> | <b>715.371</b> | <b>5.155</b> | <b>772.517</b> | <b>5.560</b> | <b>827.980</b> | <b>5.932</b> | <b>884.692</b> | <b>6.310</b> | <b>977.102</b> | <b>6.972</b> | <b>1.042.272</b> | <b>7.592</b> | <b>1.065.710</b> | <b>7.881</b> | <b>1.087.342</b> | <b>8.179</b> | <b>1.106.569</b> | <b>8.966</b> | <b>1.112.044</b> | <b>9.132</b> | <b>1.260.313</b> | <b>10.160</b> | <b>Budgetary Central Government and Government Guaranteed Debt</b> |
| 1        | I Jashtëm                                                                | 307.999        | 2.219        | 333.935        | 2.404        | 357.622        | 2.562        | 363.906        | 2.596        | 412.429        | 2.943        | 490.898          | 3.576        | 504.589          | 3.731        | 510.286          | 3.838        | 526.259          | 4.264        | 514.754          | 4.227        | 616.529          | 4.970         | External                                                           |
| 2        | I Brendshëm                                                              | 407.372        | 2.936        | 438.582        | 3.157        | 470.358        | 3.370        | 520.786        | 3.715        | 564.673        | 4.029        | 551.374          | 4.016        | 561.120          | 4.149        | 577.056          | 4.340        | 580.310          | 4.702        | 597.290          | 4.905        | 643.784          | 5.190         | Domestic                                                           |
| <b>C</b> | <b>Borxhi Qeverisë Qendrore Buxhetore</b>                                | <b>669.945</b> | <b>4.828</b> | <b>724.201</b> | <b>5.213</b> | <b>774.528</b> | <b>5.549</b> | <b>833.368</b> | <b>5.944</b> | <b>922.563</b> | <b>6.583</b> | <b>986.242</b>   | <b>7.184</b> | <b>1.012.241</b> | <b>7.485</b> | <b>1.037.457</b> | <b>7.803</b> | <b>1.061.897</b> | <b>8.604</b> | <b>1.070.191</b> | <b>8.789</b> | <b>1.211.227</b> | <b>9.764</b>  | <b>Budgetary Central Government Debt</b>                           |
| 1        | I Jashtëm                                                                | 268.124        | 1.932        | 294.276        | 2.118        | 319.833        | 2.291        | 332.500        | 2.372        | 383.922        | 2.740        | 465.306          | 3.389        | 481.407          | 3.560        | 490.518          | 3.689        | 496.804          | 4.025        | 488.056          | 4.008        | 584.655          | 4.713         | External                                                           |
| 2        | I Brendshëm***                                                           | 401.821        | 2.896        | 429.925        | 3.095        | 454.695        | 3.257        | 500.868        | 3.573        | 538.641        | 3.844        | 520.936          | 3.795        | 530.834          | 3.925        | 546.939          | 4.114        | 565.093          | 4.579        | 582.136          | 4.781        | 626.572          | 5.051         | Domestic***                                                        |
| <b>D</b> | <b>Borxhi i Garantuar i Qeverisë Qendrore</b>                            | <b>45.425</b>  | <b>327</b>   | <b>48.316</b>  | <b>348</b>   | <b>53.453</b>  | <b>383</b>   | <b>51.324</b>  | <b>366</b>   | <b>54.540</b>  | <b>389</b>   | <b>56.030</b>    | <b>408</b>   | <b>53.468</b>    | <b>395</b>   | <b>49.885</b>    | <b>375</b>   | <b>44.672</b>    | <b>362</b>   | <b>41.853</b>    | <b>344</b>   | <b>49.087</b>    | <b>396</b>    | <b>Central Government Guaranteed Debt</b>                          |
| 1        | I Jashtëm                                                                | 39.875         | 287          | 39.659         | 285          | 37.790         | 271          | 31.406         | 224          | 28.507         | 203          | 25.591           | 186          | 23.182           | 171          | 19.768           | 149          | 29.454           | 239          | 26.698           | 219          | 31.874           | 257           | External                                                           |
| 2        | I Brendshëm                                                              | 5.551          | 40           | 8.657          | 62           | 15.663         | 112          | 19.918         | 142          | 26.033         | 186          | 30.439           | 222          | 30.286           | 224          | 30.117           | 227          | 15.218           | 123          | 15.154           | 124          | 17.212           | 139           | Domestic                                                           |
| <b>E</b> | <b>Borxhi i Pushtetit Lokal*</b>                                         | <b>147</b>     | <b>1</b>     | <b>215</b>     | <b>2</b>     | <b>285</b>     | <b>2</b>     | <b>387</b>     | <b>3</b>     | <b>863</b>     | <b>6</b>     | <b>957</b>       | <b>7</b>     | <b>901</b>       | <b>7</b>     | <b>827</b>       | <b>6</b>     | <b>716</b>       | <b>6</b>     | <b>582</b>       | <b>5</b>     | <b>468</b>       | <b>4</b>      | <b>Local Government Debt*</b>                                      |
| 1        | I Jashtëm                                                                |                |              |                |              |                |              |                |              |                |              |                  |              | 0                |              | 0                |              | 0                |              | 0                |              | 0                | 0             | External                                                           |
| 2        | I Brendshëm                                                              | 147            | 1            | 215            | 2            | 285            | 2            | 387            | 3            | 863            | 6            | 957              | 7            | 901              | 7            | 827              | 6            | 716              | 6            | 582              | 5            | 468              | 4             | Domestic                                                           |

\*) Huatë e marra nga sektori bankar/Loans received from banking sector

\*\*) Deri më 30.09.2020, të dhëna paraprake/As of September 30, 2020, data are preliminary

\*\*\*) Përfshihet rivelehtësimi i valutës/Foreign Exchange Reserve Reevaluation is included

**Tabela 2: Borxhi i Qeverisë Qendrore buxhetore dhe Borxhi i garantuar**  
**Table 2: Gross Budgetary Central Govt Debt Position and Government guaranteed debt**

ALL million

|                                               | 2019 Q4          | 2020 Q1          | 2020 Q2          | 2020 Q3          |                                                 |
|-----------------------------------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------------------------------------|
| <b>Borxhi i Qeverisë Qendrore Buxhetore</b>   |                  |                  |                  |                  | <b>Gross Budgetary Central Government Debt</b>  |
| <b>Sipas maturimit dhe Instrumentave</b>      | <b>1.112.044</b> | <b>1.161.939</b> | <b>1.265.464</b> | <b>1.260.313</b> | <b>By maturity and type of instrument:</b>      |
| <b>Afatshkurtër sipas maturimit origjinal</b> | <b>208.894</b>   | <b>212.985</b>   | <b>221.728</b>   | <b>214.481</b>   | <b>Short-term by original maturity</b>          |
| Letra me Vlerë të Borxhit                     | 193.739          | 197.489          | 212.600          | 205.364          | Debt securities                                 |
| Kredi                                         | 15.154           | 15.496           | 9.128            | 9.117            | Loans                                           |
| <b>Afatgjatë sipas maturimit origjinal</b>    | <b>903.150</b>   | <b>948.955</b>   | <b>1.043.736</b> | <b>1.045.833</b> | <b>Long-term, by original maturity:</b>         |
| <b>Me shlyerje brenda një viti</b>            | <b>115.082</b>   | <b>121.761</b>   | <b>114.377</b>   | <b>112.955</b>   | <b>With payments due in one year or less:</b>   |
| Letra me Vlerë të Borxhit                     | 114.418          | 120.809          | 113.017          | 111.560          | Debt securities                                 |
| Kredi                                         | 664              | 951              | 1.359            | 1.395            | Loans                                           |
| <b>Me shlyerje mbi një vit</b>                | <b>788.068</b>   | <b>827.194</b>   | <b>929.360</b>   | <b>932.878</b>   | <b>With payments due in more than one year:</b> |
| Letra me Vlerë të Borxhit                     | 365.306          | 372.665          | 473.860          | 483.319          | Debt securities                                 |
| Kredi                                         | 422.763          | 454.529          | 455.500          | 449.559          | Loans                                           |
